



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Mbledhja nr.12/24

Prishtinë, më 5.6.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë Armend Muja, Enver Haliti, Jeta Statovci, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti, Mërgim Lushtaku, Ferat Shala dhe Duda Balje.

Të ftuar: Hekuran Murati, Naime Binaku-Jusufi AKRK, Kaltrina Sela AKRK, Nafije Osdautaj AKRK, Florent Mehmeti AKRK, Salihe Gashi-Loku AKRK, Selajdin Beqa AKRK, Arsim Tërnavë AKRK

Pjesëmarrësit tjerë Diar Beqaj D+, Sanije Berisha OSBE, Naim Jakaj IKD, Ferid Pula GP-PDK, Nexhmije Ahmeti Kuvendi, Qendresa Duraku RTK, Flutura Sogojeva EO.

Stafi mbështetës i Komisionit Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Diar Beqaj, praktikant në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rëndit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrotjtjes për Projektligjin nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës;**
- 3. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-275 për Rrugët;**
- 4. Shqyrtimi i raportit me amendamente për Projektligjin nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149;**
- 5. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;**
- 6. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për Projektligjin 08/L- 294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2023;**
- 8. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik për vitin 2023;**
- 9. Të ndryshme.**

1.Miratimi i rëndit të ditës;

Para se të miratohet rendi i ditës, kryetari propozoi edhe një pikë shtesë, si në vijim:

- 1. Shqyrtimi i raportit me rekomandime Komisionit Funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, media dhe zhvillim rajonal për Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media, i cili nuk përmban implikime buxhetore shtesë.**

Pas votimit, kryetari konstatoi miratimin e rendit të ditës me këtë ndryshim.

- 2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrotjtjes për Projektligjin nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës**

Kryetari: Projektligji nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës është shqyrtuar nga

Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligjin nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës do të ketë kosto shtesë buxhetore, në shumë prej 600,000 euro, mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024 dhe vlershmet për vitet 2025-2026, mjete buxhetore të cilat nuk janë planifikuar me Ligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 dhe planifikimin për vitin 2025-2026. Kjo kosto shtese ka të bëjë me kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa si dhe mallra dhe shërbime.

Ndërsa amendamentet e Komisionit Funksional nuk kanë kosto shtese buxhetore.

(Sipas Departamentit të Buxhetit, kostoja shtesë e propozuar në kategorinë e shpenzimeve paga dhe shtesa, bie në kundërshtim me Ligjin nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik, pasi që zyrtaret e punësuar në Këshillin e Sigurisë Republikës së Kosovës nuk përjashtohen nga ky ligj).

Meqenëse Projektligjin nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës ka implikime financiare, ne për këtë pikë e kemi ftuar ministrin e Financave z. Hekuran Murati, të cilit ja jep fjalën.

Hekuran Murati: Faleminderit, i nderuar Kryetar. Të nderuar deputetë, Anëtarë të komisionit, në lidhje me pikat e rendit të ditës, pra implikimet financiare buxhetore të projektligjeve të reja, mund të konstatoj që përfshirët pikët, pra për Këshillin e Sigurisë të Kosovës, është e vërtetë që ka tejkalim të kufijve buxhetorë mbi ato që janë në Ligjin e Buxhetit dhe kornizën e afatmesme të shpenzimeve, megjithatë si qeveri, domethënë përmes miratimit të këtij projektligji dhe drejtimit në Kuvendin për miratim, kemi shprehë vullnetin që jemi të gatshëm pra që t'i përfshijmë brenda kufijve buxhetore dhe shpenzimet e nevojshme përgjatë viteve në vijim. Pra, konfirmoj që mund të akomodojmë në mënyrë graduale shpenzime të tilla, marrë parasysh që amendamentet e reja pra nuk kanë implikime. Amendamentet e bëra nga komisioni nuk kanë implikime shtesë buxhetore, të natyrës formale edhe substanciale, por pa implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës përmban implikime buxhetore shtese, por të përbalueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionin funksional për Projektligji nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149

Kryetari: Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149 është shqyrtuar nga Komisionit funksional për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore, duke nënkuptuar që të gjitha aktivitetet që dalin nga zbatimi i këtij Ligji do të mbulohen nga Ministria e Drejtësisë, përkatësisht nënprogrami Departamenti për Profesione të Lira.

Po ashtu, as amendamentet e Komisionit funksional nuk kanë kosto shtesë buxhetore.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149, nuk përmban kosto shtese buxhetore, për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Projektligjin nr.08/L-272 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.08/L-149, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për Projektligjin 08/L- 294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë

Kryetari: Projektligji 08/L- 294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është shqyrtuar nga Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal dhe e ka dërguar raportin me amendamente.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligjin 08/L- 294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, as amendamentet e Komisionit funksional nuk kanë kosto shtesë buxhetore.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësim e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk përmban implikime buxhetore shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësim e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë;

5.Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Mandate Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Kryetari: Projektligji nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, është shqyrtuar nga Komisionit funksional për Legjislacion Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, i cili komision ka dërguar raportin me amendamente.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligji nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, as amendamentet e Komisionit funksional nuk kanë kosto shtesë buxhetore.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk përmban kosto shtese buxhetore, për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Projektligjin nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë;

6. Shqyrtimi i raportit më amendamente i Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për Projektligjin nr.08/L-275 për Rrugët

Kryetari: Projektligji nr. 08/L-275 për Rrugët është shqyrtuar nga Komisionit funksional për për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, Mbrojtjes cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente. Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohe për koston shtesë të Projektligjit, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se Projektligjin nr. 08/L-275 për Rrugët **do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 24,000 euro, për vitet 2024-2025**, në kategorinë e pagave dhe shtesave, që ndërlidhet me diferencën në pagë nga kalimi prej pozitës së drejtorit të departamentit në kryeshef ekzekutiv të Agjencisë për Menaxhimin e Rrugëve, nënprogram në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ndërsa, Amendamentet e Komisionit Funksional nuk kanë kosto shtese buxhetore.

Meqenëse **Projektligji nr.08/L-275 për Rrugët** ka implikime financiare edhe për këtë pikë e kemi ftuar ministrin e Financave, z. Hekuran Murati .

Hekuran Murati: Edhe në lidhje me këtë, pra domethënë siç po shihet nga opinioni për vlerësimin e ndikimit buxhetor, devijimi apo tejkalimi i kufijve ekzistues është për diku 12,000 Euro në vit, pra për vitet pasuese që nuk po besoj që paraqet ndonjë problem sa i përket akomodimit brenda për brenda kufijve ekzistues. Prandaj, konsideroj që kjo nuk përbën barrë të papërbalueshme.

Ferat Shala: I nderuar ministër, pajtohem që nuk paraqet shumë të madhe, po a mund ta kem një sqarim, çka po ndodh, sidomos dy vitet e fundit, me rritjen e numrit të agjencive ekzekutive në këtë nivel? Pra, realisht ky ligj vetëm një çështje rregullon: e krijoni një agjenci të re, që nuk ka ekzistua dhe normalisht që reflekton te paga, sepse duhet me vendosë një tashmë jo drejtor departamenti ose drejtor të Drejtorisë së Rrugëve, por një kryeshef ekzekutiv të një agjencie, i cili ka kompetenca krejt tjera. Vetëm këtë vit konsideroj në Ministrinë e Tregtisë shuhet pjesë, formohet një agjenci pranë Zyrës së Kryeministrit, shuhet një Inspektorat, formohen 2 pranë Zyrës së Kryeministrit, të gjitha parashikimet, rekomandimet, edhe të qenit ju më herët në opozitë, po edhe faktorë relevantë ndërkombëtarë, që kanë bërë analizë, kanë rekomandua që ne kemi ashtu shumë numër të agjencive dhe ekzekutivit, unë ju them me sinqeritet kam pritur që ju do t'i reduktoni, fuziononi, funksionalizoni, ato të cilat parimisht keni thënë që janë keq, janë shumë, janë mbushur me militantë.

Sot po krijohen pothuajse çdo muaj nga një agjenci e re ekzekutive me legjislacion, me paga shtesë dhe me mjete financiare shtesë, për të njëjtin funksion që e kanë krye administrata në të kaluarën, dhe janë planifikuar, disa janë ende për shkak të disa ankesave nëpër gjykata. Pra, në këtë relacion implikime shtesë paraqesin edhe mbetja jashtë punëtorëve, e kemi rastin e fundit, inspektorat, krijohet një agjenci për Inspektoratin Qendror, mbesin qindra njerëz nëpër të gjitha pushtetet lokale pa punë, pa thënë qindra, por me siguri afër qindra dhe në anën tjetër krijohet një agjenci e re dhe parashihet komplet rekrutim i stafit të ri, nuk i keni pasur as në

program qeveritar, as në program partiak, nuk i kemi parë ndonjëherë.

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-275 për Rrugët, përmban implikime buxhetore shtesë, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, për Projektligji nr.08/L-275 për Rrugët, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media

Kryetari: Projektligji nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media është shqyrtuar nga Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal dhe e ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, është ngarkuar që të shqyrtojë projektligjin në cilësinë e komisionit të përhershëm, komisioni deklarohet për koston shtesë të Projektligjit, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se **Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 823,985 euro dhe shtimi të numrit të stafit për 24 zyrtarë – kostoja shtesë buxhetore është mbi ndarjet e planifikuara buxhetore (për vitet 2023-2025, dhe vlerësimet 2023 dhe 2024 për Komisionin e pavarur për media).**

(Sqarim: deklarata financiare është përgatitur me datë 27.9.2022)

Ndërsa, amendamentet e Komisionit funksional, nuk kanë kosto shtesë buxhetore.

Sipas Departamentit të Buxhetit, vlerësohet se kostoja shtesë e Projektligjit për Komisionin e Pavarur për Mediave në shumë prej **823,985 euro** për vitet 2023-2024 të parapara më Ligjin 2023-2024 është mbivlerësuar në kërkesë për staf shtesë (24 zyrtarë), dhe shumën 411,025 euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitet 2023-2024, meqenëse **përfshinë një rritje prej 61% të stafit aktual të KPM-së.**

Kryetari, me shumicë votash konstatoi se komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media përmban implikime buxhetore shtesë, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur për Media, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë;

8. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2023;

Kryetari konstatoi se shtyhet votimi për një mbledhje tjetër, pasi që të merren përgjigjet nga pyetjet e parashtruara nga deputetët, për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2023

Kryetari konstatoi se pasi që ende nuk e kemi pranuar raportin nga Komisioni për Mbikëqyrjen e financave Publike vendimi për këtë pikë do të merret pas pranimin të tij.

10. Të ndryshme

Nuk pati çështje të tjera të ngritura:

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit